



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:019453

Datë: 08.02.2019

Numri i dokumentit: 00221440

P.nr.1117/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, sipas Gjyqtarës Florije Zatriqi, me pjesëmarrjen e sekretarës juridike Bute Noci, në lëndën penale kundër të pandehurit, S. A. i akuzuar për vepër penale *lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1.lidhur me nën.paragrafin 1.1 të KPRK-së*, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2344/16 i datës 13.12.2016, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 29.01.2019, në praninë e Prokurores së Shtetit Suada Hamza, të pandehurit dhe të dëmtuarës D. A., murr, publikisht shpalli dhe me dt. 05.02.2019, përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

S. A. i lindur me datë ..., nga babai Q. dhe nëna L. e gjinisë S., i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën profesionale të ndërtimtarisë, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit ..., lëshuar nga MPB R. e Kosovës, i nacionalitetit boshnjak, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar nga gjykata,

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

-Me datën 14.10.2016 rreth orës 16:00, në shtëpinë e tij, me dashje i shkaktojnë lëndime trupore bashkëshortes së tij të dëmtuarës D. A., në atë mënyrë pasi që i pandehuri kthehet në shtëpi i dehur së pari fillon me fjalë fyese, ku më pas i pandehuri S.A. sulmon fizikisht të dëmtuaren duke e kapur për fyti dhe shtrenguar, ku si pasojë e kësaj e dëmtuara e lartëcekur pëson lëndime të lehtë trupore të përshkruara si në akt-ekspertimin mjeko-ligjor të Dr. F. D. i dt. 21.11.2016.

- me çka ka kryer veprë penale *lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1.lidhur me nën.paragrafin 1.1 të KPRK-së,*

Andaj, gjykata konform nenit 7, 8 par. 1, 9, 10 par. 1, 17 par. 1, 21, 41, 42, 50, 51, 52 par. 1 dhe 3, 73, 74 dhe *nenit 188 par.1 e lidhur me nënpar.1.1 të KPRK-së,* dhe nenit 245, 246, 248 par 1 dhe 4, 359, 360, 361, 365, 366, 450 dhe 463 të KPPRK-se, të pandehurit i shqipton::

DENIM ME KUSHT

Ashtu që të pandehurit i përcaktohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej **tre (3) muaj**, i cili dënim fare nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej **një (1) viti**, nuk kryen ndonjë veprë të re penale.

I pandehuri lirohet nga pagesa e shpenzimeve procedurale, pasi që i njëjti është i gjendjes së dobët ekonomike.

E dëmtuara D. A., hjek dorë nga kërkesa për kompensimin e dëmit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i përgjithshëm, ka ngrit aktakuzën PP.II.nr.2344/16 i datës 13.13.2016, ndaj të pandehurit S. A., i akuzuar për veprë penale *lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 lidhur me nën.paragrafin 1.1 të KPRK-së.*

Gjykata ka mbajtur seancën fillestare për dt. 29.01.2019, në prezencë të prokurorit të shtetit, të pandehurit dhe të dëmtuarës, ku i pandehuri u njoftua me të drejtat e tij, u njoftua me aktakuzën dhe provat kundër tij. Pas kësaj prokurori lexoj aktakuzën kundër të pandehurit.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit, i pandehuri u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet sipas aktakuzës.

Pas deklarimit të të pandehurit se e pranon fajësinë, mendimit të prokurorit i cili nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, gjykata konstatoj se i pandehuri pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion. I pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1, të KPPRK-se janë përmbushur. Andaj, gjykata aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata, ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 326 par 4 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të të pandehurit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 248 par. 4 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, si dhe me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit S. A. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale *lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi I lidhur me nën.paragrafin 1.1 të KPRK-së*.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se tek i pandehuri, ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese në kuptim të nenit 73 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata gjeti se, i pandehuri ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit fillestar, për më tepër ka pranuar fajësinë për veprën që e ka kryer, kërkon falje para gjykatës, thellë është penduar për veprimet e veta, i premtonte gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprimet e tilla. Si rrethanë lehtësuese gjykata pati parasysh edhe vetë deklarin e të dëmtuarës D. A. – bashkëshortes së të pandehurit, e cila nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale, nuk kërkon kompensim dëmi, se janë bashkëshortë dhe nga dita kritike nuk kanë pas probleme. Këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të të pandehurit. Rrethana renduese për të pandehurin gjykata nuk gjeti.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, të pandehurin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur në përfundim se, dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 41 të KPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 453 par. 4 të KPRK-së, gjykata e liroi të pandehurin nga shpenzimet e procedurale dhe paushalli gjyqësor për shkak se, i njëjti është ba i dy fëmijëve, i pa punë dhe i gjendjes së dobët ekonomike, andaj pagesa e tyre do të rrezikonte gjendjen materiale të të pandehurit dhe personave që ai detyrohet të mbështesë materialisht, duke pas parasysh se një fëmijë është me nevoja të veçanta.

Meqenëse pala e dëmtuar ka hjek dorë nga kërkesa për kompensimin e dëmit, gjykata nuk vendosi në këtë drejtim.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 365 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.1117/16 më datë 29.01.2019

Sekretarja Juridike

G j y q t a r j a

Bute Noci

Florije Zatriqi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:019453
Datë: 08.02.2019
Numri i dokumentit: 00221440